

LIGJ
Nr. 77/2016

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS SË VEÇANTË PËR NEGOCIMIN DHE
LIDHJEN E KONTRATËS NDËRMJET SHTETIT SHQIPTAR DHE KOMPANISË
“STAR BRIDGE PORT DEVELOPMENTS LIMITED”, ME OBJEKT PROJEKTIMIN,
NDËRTIMIN, OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE MENAXHIMIN E PORTIT TË
KARPENIT, ZONËS MBËSHTETËSE TË PORTIT DHE ASAJ EKONOMIKE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj përcakton procedurën e veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës ndërmjet shtetit shqiptar dhe kompanisë “Star Bridge Port Developments Limited”, me objekt projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e portit të Karpenit, zonës mbështetëse të portit dhe asaj ekonomike.

Neni 2

Procedura e negocimit

Procedura e negocimit për lidhjen e kontratës ndiqet nga Komisioni i Negocimit të Kontratës, i kryesuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministria e Energjisë dhe Industrisë, me anëtarë, përfaqësues të Ministrisë së Financave, Ministrisë së Drejtësisë dhe Avokaturës së Shtetit, i cili fillon negociatat brenda afatit prej 45 ditësh nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Komisioni i Negocimit të Kontratës asistohet nga një konsulent i huaj, i cili bën vlerësimet ligjore dhe financiare të propozimit të paraqitur dhe kontratës që do të lidhet. Përzgjedhja e konsulentit bëhet nga Avokatura e Shtetit, në përputhje me vendimin nr. 392, datë 8.4.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale””.

Komisioni i Negocimit të Kontratës negocion me kompaninë “Star Bridge Port Developments Limited” propozimin e paraqitur prej tyre dhe përpilon projektkontratën finale, shoqëruar me relacionin përmbyllës të negociatave.

Projektkontrata, e shoqëruar me relacionin përmbyllës të negociatave, brenda një afati prej 60 ditësh nga data e nisjes së negociatave, u dërgohet për nënshkrim Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministrit të Energjisë dhe Industrisë.

Neni 3

Nënshkrimi i kontratës

Nënshkrimi i kontratës nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministri i Energjisë dhe Industrisë bëhet brenda afatit kohor prej 10 ditësh nga data e marrjes së projektkontratës dhe relacionit përmbyllës të negociatave.

Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministri i Energjisë dhe Industrisë mund t'i kërkojnë Komisionit të Negocimit të Kontratës rishikimin e projekt-kontratës. Ky komision duhet të rinegociojë dhe t'ua paraqesë për nënshkrim ministrave projekt-kontratën, të shoqëruar me relacionin përmbyllës të negociatave, brenda afatit kohor prej 30 ditësh, duke filluar nga afati i rikthimit.

Neni 4

Miratimi i kontratës

Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministri i Energjisë dhe Industrisë dërgojnë për miratim në Këshillin e Ministrave projektligjin e hartuar nga Komisioni i Negocimit të Kontratës, brenda 10 ditëve nga data e nënshkrimit të saj nga të tre ministrat.

Kontrata miratohet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Data e hyrjes në fuqi të kontratës do të jetë data e hyrjes në fuqi të ligjit, pas miratimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Ilir Meta

Miratuar në datën 22.7.2016